



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.949 /19

PANELI SHQYRTUES, emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina- Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues, z. Goran Milenković -Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: N.T.P “LULISHTJA BUÇAJ”-Graçanicë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik: N.T.P. Fidanishtja “Gjelbrimi” &N.T.P. “LalPallmas”– Malishevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“Krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjëve dekorativ-Lot1”me nr. të prok:623-19-6024-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Rahovec,më datën: 29.01.2020, mori këtë:

U R D H Ë R E S Ë

I.APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.P “LULISHTJA BUÇAJ”-Graçanicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“Krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjëve dekorativ-Lot1”me nr. të prok:623-19-6024-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK- KK Rahovec.

II.OBLIGOHET, autoriteti kontraktues / Kuvendi Komunal Rahovec /, që të zbatojë vendimin e OSHP-së me numër: PSH nr. 683/19, i protokolluar me datë: 19.11.2019, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: “Krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjëve dekorativ-Lot1”me nr. të prok:623-19-6024-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Rahovec.

III. URDHËROHET, autoriteti kontraktues / Kuvendi Komunal Rahovec /, që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në, dhe operatorin ekonomik N.T.P “LULISHTJA BUÇAJ”-Graçanicë, lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së, me numër PSH.nr. 683/19, i protokolluar me datë: 19.11.2019, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull “Krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjëve dekorativ-Lot1”me nr. të prok:623-19-6024-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Rahovec.

IV. Mos respektimi i kësaj urdhërese, brenda periudhës prej pesë ditë kalendarike, do ta detyroj Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së, dhe njëkohësisht të kërkoj nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK-së / Kuvendi Komunal Rahovec /sipas nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.T.P “LULISHTJA BUÇAJ”-Graçanicë, aprovohet si e bazuar, të njëjtit operator ekonomik i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues N.T.P “LULISHTJA BUÇAJ”-Graçanicë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 23.12.2019 me nr. 949/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjëve dekorativ-Lot1” me nr. të prok:623-19-6024-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Rahovec, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 57, 59, 60, 65, 69, 71, 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 39 të RRUOPP-së, dhe Vendimin PSH.nr. 683/19 i dt:19.11.2019 si dhe nenin 29 të Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.12.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt:30.12.2019, sqaron si në vijim:

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59, 60, 69, 71 të LPP-së, si dhe Ligji Nr. 05/L -037 Neni 29: Lirimet në importim. Eksperti shqyrtues sqaron, se bazuar në Rregulloren Nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë lidhur me këto pretendime

ankimor, ku objekt i kontestit dhe palët janë të njëjta, për rastet të cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje të gjykuara “resjudikata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së, andaj nuk janë trajtuar nga ekspertit shqyrtues.

Ekspertit shqyrtues sqaron, se AK - komisioni i ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar drejt ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së me Nr. 683/19, të datës 19.11.2019, duke mos ka vepruar në tërësi në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, të aprovohet e bazuar, dhe rekomandon të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 30.12.2019 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 30.12.2019 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 29.01.2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverballi mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues, duke pasur parasysh dëshmitë që i ka pasur në dispozicion, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues / Kuvendi Komunal Rahovec /, nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-së, PSH.nr 683/19, i protokolluar me datë: 19.11.2019, ku është vendosur që të “aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.P “LULISHTJA BUÇAJ”-Graçanicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjëve dekorativ-Lot1” me nr. të prok:623-19-6024-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Rahovec, dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues N.T.P “LULISHTJA BUÇAJ”-Graçanicë, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59, 60, 69, 71 të LPP-së, si dhe Ligji Nr. 05/L -037 Neni 29: Lirimet në

importim. Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron, se bazuar në Rregulloren Nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore të njëjta për palët ne procedurë lidhur me këto pretendime ankimor, ku objekt i kontestit dhe palët janë të njëjta, për rastet të cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje te gjykuara “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 te LPP-së, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Paneli shqyrtues konstaton se kjo çështje është “Res Judicata” apo çështje e gjykuar ne vendimin PSH.nr. 683/19 të datës 19.11.2019.

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron, se AK - komisioni i ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar drejt ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së me Nr. 683/19, të datës 19.11.2019, duke mos vepruar ne tërësi ne pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues me vendimin PSH.nr.683/19, i protokolluar me datë: 19.11.2019, vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, pasi qe ka rekomanduar për kontrate një OE qe nuk i plotëson kërkesat e AK-se të publikuara ne njoftimin për kontrate dhe dosje të tenderit dhe njëkohësisht obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit të respektoj ne përpikëri të gjitha dispozitat e LPP-së dhe kërkesat e veta të vendosura ne njoftimin për kontrate dhe dosje të tenderit. Andaj, ju bëjmë me dije se vendimet e OSHP-së, janë të obligueshme për tu zbatuar nga ana e autoriteteve kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët kanë të drejt ti drejtohen gjykatës kompetente brenda afatit ligjor me anë të mjeteve të rregullta juridike, konform këshillës juridike të dhënë në vendim.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 dhe 105 paragrafi 2.10 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të kësaj urdhërese.



t'i dorëzohet:

1x1 AK- Kuvendi Komunal Rahovec

1x1 OE- N.T.P “LULISHTJA BUÇAJ”-Graçanicë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.